

**Direktiva 2001/80/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit Europian e 23 Tetorit 2001 mbi kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet e mëdha të djegies**

Gazeta Zyrtare L 309, 27.11.2001 fq. 1–21

Direktiva 2001/80/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit Europian e 23 Tetorit 2001 mbi kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet e mëdha të djegies

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke marrë në konsideratë Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 175 pikën (1) të tij,

Duke marrë në konsideratë propozimin nga Komisioni,<sup>1</sup>

Duke marrë në konsideratë mendimin e Komitetit<sup>2</sup> Ekonomik dhe Social,

Pas konsultimit me Komitetin e Rajoneve,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit<sup>3</sup>, duke marrë parasysh tekstin e përbashkët të miratuar nga Komiteti i Pajtimit më 2 gusht 2001,

Duke pasur parasysh se:

- (1) Direktiva e Këshillit 88/609/KEE e 24 nëntorit 1988, mbi kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet e mëdha të djegies<sup>4</sup> ka kontribuar në zvogëlimin dhe kontrollin e emetimeve atmosferike nga impiantet e mëdha djegëse. Duhet të ripërpunohet për qëllime të qartësimit të mëtejshëm.
- (2) Programi i Pestë i Veprimit Mjedisor<sup>5</sup> cakton si objektiva që ngarkesat kritike dhe nivelet e disa ndotësve acidifikues, si dyoksidi sulfurik (SO<sub>2</sub>) dhe oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>) nuk duhet të tejkalohen në asnjë kohë dhe për sa i përket cilësisë së ajrit, të gjithë njerëzit duhet të mbrohen në mënyrë efektive nga rreziqet e njohura shëndetësore për shkak të ndotjes së ajrit.
- (3) Të gjitha Shtetet Anëtare kanë nëshkruar Protokollin e Goteborgut të 1 dhjetorit 1999 të Konventës të Komisionit Ekonomik për Europën të Kombeve të Bashkuara (KEEKB) 1979, mbi ndotjen ndërkufitare afatgjatë të ajrit për të zvogëluar acidifikimin, eutrofikimin dhe ozonin në nivelin e tokës që përfshin ndër të tjera, angazhimet për të zvogëluar emetimet e dyoksidit sulfurik dhe oksideve të azotit.
- (4) Komisioni ka publikuar një komunikatë mbi një strategji Komunitare për luftimin e acidifikimit në të cilën rishikimi i Direktivës 88/609/KEE u identifikua si komponent përbërës i asaj strategjie, me synimin afatgjatë të zvogëlimit të emetimeve të dyoksidit sulfurik dhe oksideve të azotit, në nivel të mjaftueshëm për të çuar depozita dhe përqendrime në nivele të ngarkesave kritike.
- (5) Në bazë të parimit të subsidiaritetit, sikurse përcaktohet në nenin 5 të Traktatit, qëllimi i zvogëlimit të emetimeve acidifikuese nga impiantet e mëdha djegëse, nuk mund të arrihet në nivel të mjaftueshëm nga Shtetet Anëtare, që veprojnë individualisht dhe veprimi i papajtueshëm nuk ofron asnjë garanci për arritjen e qëllimit të dëshiruar; duke marrë parasysh nevojën për zvogëlimin e emetimeve acidifikuese në Komunitet, ndërmarrja e një veprimi në nivel Komuniteti është më efektive.
- (6) Impiantet e mëdha ekzistuese të djegies janë kontribuues të rëndësishëm për emetimet e dyoksidit sulfurik dhe oksidet e azotit në Komunitet, dhe zvogëlimi i këtyre emetimeve është i nevojshëm.

<sup>1</sup> GZ C 300, 29.09. 1998, fq. 6, GZ C 212 E, 25. 07. 2000, fq. 36

<sup>2</sup> GZ C 101, 12. 04. 1999, fq. 55

<sup>3</sup> Mendimi i Parlamentit Europian i 14 prillit 1999 ( FZ C 219, 30. 07. 1999, fq. 175), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit i 9 nëntorit 2000 ( GZ C 375, 28. 12. 2000, fq. 12) dhe Vendimi i Parlamentit Europian i 14 marsit 2001 (ende i papublikuar në Gazetën Zyrtare). Vendimi i Parlamentit Europian i 20 shtatorit 2001 dhe Vendimi i Këshillit i 27 shtatorit 2001

<sup>4</sup> GZ L 336, 07. 12. 1988, fq. 1, Direktiva e ndryshuar së fundmi nga Direktiva e Këshillit 94/66/KE (GZ L 337, 24. 12. 1994, fq. 83)

<sup>5</sup> GZ C 138, 17. 05. 1993, fq. 1

Rrjedhimisht, zvogëlimi i këtyre emetimeve është i nevojshëm. Më tej, është e nevojshme që përjasja të përshtatet me karakteristikat e ndryshme të sektorit të impianteve të mëdha të djegies në Shtetet Anëtare.

- (7) Direktiva e Këshillit 96/61/KE e 24 shtatorit 1996, në lidhje me parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes<sup>6</sup>, parashtrohet një përjasje të integruar për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes, në të cilën shqyrtohen të gjitha aspektet e një performace mjedisore të njësisë në mënyrë të integruar; impiantet e djegies me kapacitet termik nominal që tejkalon 50 MW përfshihen brenda fushës së veprimit të kësaj direktive; sipas nenit 15 pika (3) të kësaj direktive një inventar i emetimeve kryesore dhe burimeve përgjegjëse duhet të publikohet çdo tre vjet nga Komisioni mbi bazën e të dhënave të dorëzuara nga Shtetet Anëtare. Sipas nenit 18 të kësaj direktive, duke vepruar me propozim të Komisionit, Këshilli do të caktojë vlerat kufi të emetimeve në përputhje me procedurat e përcaktuara në traktat, për të cilat është identifikuar nevoja për veprim e Komunitetit, në veçanti mbi bazën e shkëmbimit të informacionit të parashikuar në nenin 16 të kësaj direktive.
- (8) Pajtueshmëria me vlerat kufi të emetimeve të përcaktuara në këtë direktivë, duhet të konsiderohet si një kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për pajtueshmëri me kërkesat e direktivës 96/61/KE mbi përdorimin e teknikave më të mira në dispozicion. Një përputhshmëri e tillë mund të përfshijë vlera kufi më shtrënguese të emetimeve, vlera kufi të emetimeve për substanca të tjera dhe mjete dhe kushte të tjera të përshtatshme.
- (9) Përvoja industriale në zbatimin e teknikave për zvogëlimin e emetimeve ndotëse nga impiantet e mëdha të djegies është fituar gjatë një periudhe 15 vjeçare.
- (10) Protokollin mbi metalet e rënda i Konventës së UNECE-së mbi ndotjen ndërkuftare afatgjatë të ajrit, rekomandon marrjen e masave për pakësimin e metaleve të rënda të nxjerra nga disa impiante. Është fakt i njohur që përfitimet nga zvogëlimi i emetimeve të pluhurave me anë të pajisjeve për pakësimin e pluhurave do të sjellin përfitime për zvogëlimin e emetimeve të metaleve të rënda me grimca të përbëra.
- (11) Njësitë për prodhimin e energjisë përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të sektorit të impianteve të mëdha të djegies.
- (12) Direktiva 96/92/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 19 dhjetorit 1996, në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm në energji<sup>7</sup> synon, *inter alia*, për të pasur efektin e shpërndarjes së kapacitetit të ri prodhues mes arritjeve të reja në sektor.
- (13) Komuniteti angazhohet për zvogëlimin e emetimeve të dyoksidit të karbonit. Kur është e mundur, prodhimi i kombinuar i nxehtësisë dhe energjisë përfaqëson një mundësi të vlefshme për përmirësimin e dukshëm të efektivitetit të përgjithshëm në përdorimin e karburanteve.
- (14) Një rritje e konsiderueshme në përdorimin e gazit natyror për prodhimin e energjisë, tashmë është në proces dhe ka të ngjarë të vazhdojë, në veçanti nëpërmjet përdorimit të turbinave me gaz.
- (15) Me synim rritjen e prodhimit të energjisë nga biomasa, standardet e emetimeve specifike për këtë karburant janë të justifikuar.
- (16) Rezoluta e Këshillit e 24 shkurtit 1997, mbi një strategji Komunitare për menaxhimin e mbetjeve<sup>8</sup>, thekson nevojën për promovimin e riciklimit të mbetjeve dhe deklaron se duhet të zbatohen standardet e përshtatshme të emetimeve për funksionimin e ambienteve në të cilat digjen mbetjet, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mbrojtjeje për mjedisin.

<sup>6</sup> GZ L 257, 10. 10. 1996, fq. 26

<sup>7</sup> GZ L 27, 30. 01. 1997, fq. 20

<sup>8</sup> GZ C 76, 11. 03. 1997, fq. 1

- (17) Është fituar përvoja industriale në lidhje me teknikat dhe pajisjet për matjen e ndotësve kryesorë të emetuar nga impiantet e mëdha të djegies; Komiteti European për Standardizimin (KES) ka filluar punë me qëllim sigurimin e një kuadri, që garanton rezultate të krahasueshme matjeje brenda Komunitetit dhe nivel të lartë cilësie të këtyre matjeve.
- (18) Ka nevojë për përmirësimin e njohurive në lidhje me emetimin e ndotësve kryesorë nga impiantet e mëdha të djegies. Me qëllim që të cilësohet realisht përfaqësuesi i nivelit të ndotjes së një impianti, ky informacion duhet të shoqërohet gjithashtu me njohuri në lidhje me konsumimin e energjisë.
- (19) Kjo direktivë nuk cenon afatet kohore brenda të cilave Shtetet Anëtare duhet të përafrojnë dhe zbatojnë Direktivën 88/609/KEE,

## KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

### Neni 1

Kjo direktivë zbatohet për impiantet e djegies, kapaciteti termik nominal i të cilave është i barabartë ose më i madh se 50 MW, pavarësisht nga tipi i karburantit të përdorur (i ngurtë, i lëngshëm apo i gaztë).

### Neni 2

Për qëllimin e kësaj direktive:

- (1) “emetim” nënkupton shkarkimin në ajër të substancave nga impianti i djegies;
- (2) “mbetje të gazta” nënkupton shkarkimet e gazta që përmbajnë emetime të ngurta, të lëngshme ose të gazta; shpejtësitë e rrjedhjes së tyre volumetrike shprehen në metër kub për orë me temperaturë standarde (273 K) dhe presion (101,3 kPa) pas korrigjimit për përmbajtjen e avullit të ujit, më pas të referuara si (Nm<sup>3</sup>/h);
- (3) “vlerë kufi e emetimit” nënkupton sasinë e lejueshme të një substance që ndodhet në mbetjet e gazta nga impianti i djegies që mund të çlirohet në ajër gjatë një periudhe të caktuar; ajo llogaritet në lidhje me masën për volum të mbetjeve të gazrave shprehur në mg/Nm<sup>3</sup>, duke supozuar një përmbajtje oksigjeni me volum në mbetjen e gazit prej 3 % në rastin e karburanteve të lëngshme dhe të gazta, 6 % në rastin e karburanteve të ngurta dhe 15 % në rastin e turbinave me gaz;
- (4) “norma e çsulfurizimit” nënkupton raportin e sasisë së sqfurit që nuk emetohet në ajër në vendin e impiantit të djegies gjatë një periudhe të caktuar, me sasinë e sqfurit që ndodhet në karburant, i cili futet në mjediset e impiantit të djegies dhe përdoret gjatë një periudhe të caktuar;
- (5) “operator” nënkupton çdo person fizik ose juridik, që drejton impiantin e djegies, ose që ka deleguar, ose i është deleguar kompetenca ekonomike vendimmarrëse mbi të;
- (6) “karburant” nënkupton çdo material të ngurtë, të lëngshëm ose të gaztë të djegshëm, që përdoret për ndezjen e impiantit të djegies me përjashtim të mbetjeve të mbuluara nga Direktiva e Këshillit 89/369/KEE e 8 korrikut 1989 mbi parandalimin e ndotjes së ajrit nga impiantet e reja kryesore të djegies së mbetjeve<sup>9</sup>, Direktiva e Këshillit 89/429/KEE e 21 qershorit 1989 mbi zvogëlimin e ndotjes së ajrit nga impiantet ekzistuese kryesore të djegies së mbetjeve<sup>10</sup>, dhe Direktiva e Këshillit 94/67/KE e 16

<sup>9</sup> GZ L 163, 14.6.1989, fq. 32.

<sup>10</sup> GZ L 203, 15.7.1989, fq. 50.

dhjetorit 1994, në lidhje me djegien e mbetjeve të rrezikshme<sup>11</sup>, ose ndonjë akt të mëtejshëm të Komunitetit dhe që zëvendëson një ose më shumë nga këto direktiva ;

- (7) “impiant i djegies” nënkupton çdo aparat teknik në të cilin oksidohen karburantet për të përdorur nxehtësinë e prodhuar në këtë mënyrë.

Kjo direktivë zbatohet gjithashtu, vetëm për impiantet e djegies të projektuara për prodhimin e energjisë, me përjashtim të atyre që përdorin në mënyrë të drejtpërdrejtë produktet e djegies në proceset e prodhimit. Në veçanti, kjo direktivë nuk zbatohet për impiantet e mëposhtme të djegies:

- (a) impiantet në të cilat produktet e djegies përdoren për nxehjen, tharjen e drejtpërdrejtë, ose ndonjë trajtim tjetër të objekteve ose materialeve, për shembull furrat e rinxehjes, furrat për përpunimin e nxehtësisë;
- (b) impiantet e pas djegies, domethënë çdo aparat teknik i projektuar për të pastruar mbetjet e gazrave nga djegia, që nuk punon si impiant i pavarur djegieje;
- (c) mjediset për riciklimin e katalizatorëve të krekingut katalitik;
- (d) mjediset për shndërrimin e komponimit sulfhidrik në squfur;
- (e) reaktorët e përdorur në industrinë kimike;
- (f) furra koksi me bateri;
- (g) kauperat;
- (h) çdo aparat teknik i përdorur në vënien në lëvizje të një automjeti, anijeje ose avioni;
- (i) turbinat me gaz të përdorura në platformat në det të hapur;
- (j) turbinat me gaz të licencuara para datës 27 nëntor 2002, ose të cilat sipas autoritetit kompetent, i nënshtrohen një kërkesë të plotë për licencë para datës 27 nëntor 2002, me kusht që impianti të vihet në punë jo më vonë se data 27 nëntor 2003, pa cenuar nenin 7 pika (1) dhe Shtojcën VIII pikat (A) dhe (B);

Impiantet që punojnë me naftë, benzinë dhe motorët me gaz të djegshëm nuk do të mbulohen nga kjo direktivë.

Kur dy ose më shumë impiante të ndara instalohen në mënyrë të tillë që, duke marrë parasysh faktorët teknikë dhe ekonomikë, mbetjet e tyre të gazrave, sipas gjykimit të autoriteteve kompetente, duhet të shkarkohen nëpërmjet një tubi shkarkimi të përbashkët, kombinimi i formuar nga këto impiante duhet të konsiderohet si një njësi më vete;

- (8) “njësi ndezjeje me karburante shumëkomponentësh” nënkupton çdo impiant të djegies që mund të ndizet njëkohësisht ose me radhë, nga dy ose më shumë tipe karburantesh;
- (9) “impiant i ri” nënkupton çdo impiant të djegies, për të cilin licenca origjinale e ndërtimit ose në mungesë të kësaj procedure, licenca origjinale e punës është dhënë në datën 1 korrik 1987 ose pas kësaj date;
- (10) “impiant ekzistues” nënkupton çdo impiant të djegies për të cilin licenca origjinale e ndërtimit ose në mungesë të kësaj procedure, licenca origjinale e punës është dhënë para datës 1 korrik 1987;

---

<sup>11</sup> GZ L 365, 31.12.1994, fq. 34.

- (11) “biomasë” nënkupton produktet që përbëhen nga një lëndë e plotë ose e pjesëshme bimore, nga bujqësia ose pylltaria, që mund të përdoret si karburant për qëllim të rigjenerimit të përmbajtjes së energjisë së saj dhe mbetjet e mëposhtme të përdorura si karburant:
- (a) mbetja bimore nga bujqësia dhe pylltaria;
  - (b) mbetja bimore nga industria e përpunimit ushqimor, nëse rigjenerohet nxehtësia e gjeneruar;
  - (c) mbetje bimore fibroze nga prodhimi i brumit të letrës së papërpunuar dhe nga prodhimi i letrës nga brumi i letrës, nëse bashkëdigjet në vendin e prodhimit dhe rigjenerohet nxehtësia e gjeneruar;
  - (d) mbetjet e drurit të tapës;
  - (e) mbetjet e drurit me përjashtim të mbetjeve të drurit që mund të përmbajnë përbërës organikë të halogjenizuar ose metale të rënda, si rezultat i trajtimit me mbrojtës ose veshje druri dhe që përfshijnë, në veçanti, këto mbetje druri që e kanë origjinën nga mbetjet e ndërtimit dhe shkatërrimit;
- (12) “turbinë me gaz” nënkupton çdo makineri rrotulluese që shndërron energjinë termike në punë mekanike, që përbëhet kryesisht nga një kompresor, një aparat termik në të cilin oksidohet karburanti, me qëllim nxehtjen e lëngut të përpunuar dhe një turbinë.
- (13) “Rajonet më të Largëta” nënkuptojnë Departamentet Franceze Përtej Detit në lidhje me Francën, Azoret dhe Madeira në lidhje me Portugalinë dhe Ishujt Kanarie në lidhje me Spanjën.

### Neni 3

1. Jo më vonë se data 1 korrik 1990, Shtetet Anëtare do të hartojnë programe të përshtatshme për uljen progresive të emetimeve vjetore totale nga impiantet ekzistuese. Programet përcaktojnë oraret dhe procedurat zbatuese.
2. Në përputhje me programet e përmendura në paragrafin 1, Shtetet Anëtare do të vazhdojnë t'i përmbahen tavaneve të emetimit dhe uljeve të përqindjes korresponduese të parashtruara për dyoksidin sulfurik në Shtojcën I, kolonat 1 deri në 6, dhe për oksidet e azotit në Shtojcën II, kolonat 1 deri 4, në datat e specifikuar në ato Shtojca, deri në zbatimin e dispozitave të nenit 4 që veprojnë për impiantet ekzistuese.
3. Kur përmbushen programet, Shtetet Anëtare do të përcaktojnë gjithashtu emetimet totale vjetore në përputhje me Shtojcën VIII pika (C).
4. Nëse një ndryshim thelbësor dhe i papritur në kërkesën për energji, ose në disponueshmërinë e disa karburanteve ose disa impianteve gjeneruese, krijon vështirësi teknike serioze për zbatimin nga një Shtet Anëtar të programit të tij të hartuar sipas paragrafit 1, Komisioni, me kërkesë të Shtetit Anëtar të interesuar dhe duke marrë parasysh kushtet e kërkesës, do të marrë një vendim për të ndryshuar për atë Shtet Anëtar, tavanet e emetimeve dhe/ose datat e përcaktuara në Shtojcat I dhe II dhe i komunikon vendimin e tij Këshillit dhe Shteteve Anëtare. Brenda tre muajve, çdo Shtet Anëtar mund t'ia referojë Këshillit vendimin e Komisionit. Këshilli, duke vepruar me shumicë të cilësuar, mund të marrë një vendim të ndryshëm brenda tre muajve.

### Neni 4

1. Pa cenuar nenin 17, Shtetet Anëtare do të marrin masa të përshtatshme për të siguruar që të gjitha licencat për ndërtimin ose në mungesë të kësaj procedure, për drejtimin e impianteve të reja që sipas autoritetit kompetent, i nënshtrohen një kërkesë të plotë për licencë para datës 27 nëntor 2002, me kusht që impianti të vihet në punë jo më vonë se 27 nëntori 2003, përmbajnë kushte në lidhje me pajtueshmërinë me vlerat kufi të

emetimeve të përcaktuara në pjesën A të Aneksve III deri në VII në lidhje me dyoksidin sulfurik, oksidet e azotit dhe pluhurin.

2. Shtetet Anëtare marrin masa të përshtatshme për të siguruar që të gjitha licencat për ndërtimin ose në mungesë të kësaj procedure, për drejtimin e impianteve të reja, të ndryshme nga ato të mbuluara nga paragrafi 1, përmbajnë kushte në lidhje me pajtueshmërinë me vlerat kufi të emetimeve të parashtruara në pjesën B të Shtojcave III deri në VII në lidhje me dyoksidin sulfurik, oksidet e azotit dhe pluhurin.

3. Pa cenuar Direktivën 96/61/KE dhe Direktivën e Këshillit 96/62/KE të 27 shtatorit 1996 mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit të mjedisit<sup>12</sup>, Shtetet Anëtare maksimumi deri në 1 janar 2008, do të arrijnë zvogëlime të dukshme të emetimeve:

- (a) me anë të marrjes së masave të përshtatshme për të siguruar që të gjitha licencat për drejtimin e impianteve ekzistuese përmbajnë kushte në lidhje me pajtueshmërinë me vlerat kufi të emetimeve, për sa i përket pajtueshmërisë me vlerat kufi të emetimeve, të vendosura për impiantet e reja të referuara në paragrafin 1; ose
- (b) duke siguruar që impiantet ekzistuese i nënshtrohen planit kombëtar të zvogëlimit të emetimeve, të përmendur në paragrafin 6;

dhe kur është e përshtatshme, me anë të zbatimit të neneve 5, 7 dhe 8.

4. Pa cenuar Direktivat 96/61/KE dhe 96/62/KE, impiantet ekzistuese mund të përjashtohen nga pajtueshmëria me vlerat kufi të emetimeve të përmendura në paragrafin 3 dhe nga përfshirja e tyre në planin kombëtar të zvogëlimit të emetimeve në bazë të kushteve të mëposhtme:

- (a) operatori i një impianti ekzistues merr përsipër, në një deklaratë me shkrim të paraqitur jo më vonë se 30 qershor 2004 ndaj autoritetit kompetent, për të mos vepruar në impiant për më shumë se 20 000 orë pune që fillojnë nga data 1 janar 2008 dhe që mbarojnë jo më vonë se 31 dhjetor 2015;
- (b) operatorit i kërkohet t'i paraqesë çdo vit autoritetit kompetent të dhëna për kohën e përdorur dhe të papërdorur të lejuar për jetëgjatësinë e punës së mbetur të impianteve.

5. Shtetet Anëtare mund të kërkojnë pajtueshmëri me vlerat kufi të emetimeve dhe afatet kohore për zbatim që janë më shtrënguese sesa ato të përcaktuara në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 dhe në nenin 10. Ato mund të përfshijnë ndotës të tjerë dhe mund të vendosin kërkesa të tjera shtesë ose përshtatjen e impiantit ndaj progresit teknik.

6. Pa cenuar këtë direktivë dhe Direktivën 96/61/KE dhe duke marrë në konsideratë kostot dhe përfitimet, si dhe detyrimet e tyre sipas Direktivës 2001/81/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 23 tetorit 2001, mbi tavanet kombëtare të emetimeve për disa ndotës atmosferikë<sup>13</sup> dhe Direktivën 96/62/KE, Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë dhe zbatojnë një plan kombëtar për zvogëlimin e emetimeve për impiantet ekzistuese, duke marrë parasysh, ndër të tjera, pajtueshmërinë me tavanet e përcaktuara në Shtojcën I dhe II.

Plani kombëtar i zvogëlimit të emetimeve do të zvogëlojë emetimet totale vjetore të oksideve të azotit (NOx), dyoksidit sulfurik (SO<sub>2</sub>) dhe pluhurit, nga impiantet ekzistuese në nivelet që do të ishin arritur me anë të zbatimit të vlerave kufi të emetimeve, të përmendura në paragrafin 3 për impiantet ekzistuese në veprim në vitin 2000, (duke përfshirë ato impiante ekzistuese që i nënshtrohen një plani rehabilitimi në vitin 2000, të miratuar nga autoriteti kompetent, për të arritur zvogëlimet e emetimeve të kërkuara nga legjislacioni kombëtar, mbi bazën e kohës vjetore të punës aktuale të secilit impiant, karburantin e përdorur dhe kapacitetin termik të llogaritur mesatarisht gjatë pesë viteve të fundit të punës deri në dhe duke përfshirë vitin 2000.

<sup>12</sup> GZ L 296, 21. 11. 1996, fq. 55

<sup>13</sup> Shih fq. 22 të këtij Botimi të Gazetës Zyrtare

Mbyllja e një impianti të përfshirë në planin kombëtar të zvogëlimit të emetimeve nuk do të çojë në një rritje në emetimet totale vjetore nga impiantet që mbeten të mbuluara nga plani.

Plani kombëtar i zvogëlimit të emetimeve, në asnjë rrethanë, nuk mund të përjashtojë një impiant nga dispozitat e përcaktuara në legjislacionin përkatës të Komunitetit, duke përfshirë *inter alia* Direktivën 96/61/KE.

Kushtet e mëposhtme zbatohen për planet kombëtare të zvogëlimit të emetimeve:

- (a) plani do të përmbajë objektivat dhe synimet e ngjashme, oraret për arritjen e këtyre objektivave dhe synimeve dhe një mekanizëm vëzhgues;
- (b) Shtetet Anëtare do t'i komunikojnë Komisionit jo më vonë se 27 nëntori 2003, planin e tyre kombëtar të zvogëlimit të emetimeve;
- (c) brenda gjashtë muajve nga komunikimi i përmendur në pikën (b), Komisioni do të vlerësojë nëse plani plotëson apo jo kërkesat e këtij paragrafi. Kur Komisioni çmon që kjo nuk ka ndodhur, ai do të informojë Shtetin Anëtar dhe brenda tre muajve të mëpasshëm, Shteti Anëtar do të komunikojë çdo masë që ka marrë, me qëllim sigurimin e plotësimin të kërkesave të këtij paragrafi;
- (d) jo më vonë se 27 nëntor 2002, Komisioni do të zhvillojë udhëzimet për të ndihmuar Shtetet Anëtare në përgatitjen e planeve të tyre.

7. Jo më vonë se 31 dhjetor 2004 dhe duke marrë parasysh progresin drejt mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe arritjen e objektivave mjedisore të Komunitetit për acidifikimin dhe për cilësinë e ajrit sipas Direktivës 96/62/KE, Komisioni do t'i paraqesë një raport Parlamentit Evropian dhe Këshillit në të cilin do të vlerësojë:

- (a) nevojën për masa të mëtejshme;
- (b) sasi të metaleve të rënda të emetuara nga impiantet e mëdha djegëse;
- (c) leverdinë ekonomike, kostot dhe avantazhet e zvogëlimeve të mëtejshme të emetimeve në sektorin e impianteve të djegies në Shtetet Anëtare, në krahasim me sektorët e tjerë;
- (d) realizueshmëria teknike dhe ekonomike e këtyre zvogëlimeve të emetimeve;
- (e) pasojat e standardeve të caktuara për sektorin e impianteve të mëdha të djegies, duke përfshirë masat për karburantet e ngurta vendase dhe situatën e konkurrencës në tregun e energjisë në mjedis dhe tregun e brendshëm;
- (f) çdo plan kombëtar për zvogëlimin e emetimeve të siguruar nga Shtetet Anëtare në përputhje me paragrafin 6.

Komisioni do të përfshijë në raportin e tij një propozim të përshtatshëm të afateve përfundimtare të mundshme, ose të vlerave kufi më të ulta për përjashtimin nga rregullat e përcaktuara në shënimin fundor 2 të Shtojcës VI A.

8. Raporti i përmendur në paragrafin 7, sipas rastit, do të shoqërohet me propozime të ngjashme në bazë të Direktivës 96/61/KE.

## Neni 5

Me anë të përjashtimit nga rregullat e përcaktuara në Shtojcën III:

- (1) Impiantet e një kapaciteti termik nominal të barabartë ose më të madh se 400 MW, që nuk punojnë më shumë sesa numrat e mëposhtëm të orëve në vit (mesatarja e rrotullimit gjatë një periudhe prej pesë vjetësh),

-deri në 31 dhjetor 2015, 2 000 orë;

-nga 1 janari 2016, 1 500 orë;

do t'i nënshtrohen një vlere kufi prej 800 mg/Nm<sup>3</sup> për emetimet e dyoksidit sulfurik.

Kjo dispozitë nuk do të zbatohet për impiantet e reja, për të cilat jepet licencë sipas nenit 4 pika (2).

- (2) Deri në 31 dhjetor 1999, Mbretëria e Spanjës mund të autorizojë centrale të reja elektrike, me kapacitet termik nominal të barabartë ose më të madh se 500 MW që djeg karburante të ngurta vendase ose të importuara, të realizuara para fundit të vitit 2005 dhe në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

(a) në rastin e karburanteve të ngurta të importuara, një vlerë kufi prej 800 mg/Nm<sup>3</sup> e emetimeve të dyoksidit sulfurik;

(b) në rast të karburanteve të ngurta vendase, të paktën një normë prej 60 % e çsulfurizimit,

me kusht që kapaciteti total i autorizuar i këtyre impianteve për të cilat zbatohet ky derogim, nuk tejkalon:

- 2 000 MW në rast të impianteve që djegin karburante të ngurta vendase;

- në rast të impianteve që djegin karburante të ngurta të importuara, 7 500 ose 50 % të të gjithë kapacitetit të ri të të gjithë impianteve që djegin karburante të ngurta të autorizuara deri në 31 dhjetor 1999, cilido qoftë më i ulti.

#### Neni 6

Në rastin e impianteve të reja për të cilat jepet licencë sipas nenit 4 pika (2) ose impianteve të mbuluara nga neni 10, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të shqyrtohet realizueshmëria teknike dhe ekonomike e parashikimit të gjenerimit të kombinuar të nxehtësisë dhe energjisë. Kur të konfirmohet kjo realizueshmëri, duke marrë parasysh situatën dhe shpërndarjen e tregut, impiantet do të zhvillohen në mënyrën e duhur.

#### Neni 7

1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të merren masa për licencat ose lejet e përmendura në nenin 4 për procedurat në lidhje me keqfunksionimin ose avaritë e pajisjeve të zvogëlimit të emetimeve. Në rast të një avarie, autoriteti kompetent do t'i kërkojë në veçanti operatorit të pakësojë ose mbyllë operimet, nëse nuk arrihet kthimi në gjendje normale brenda 24 orëve ose të drejtojë impiantin që përdor karburante ndotëse të ulëta. Në çdo rast, autoriteti kompetent do të njoftohet brenda 48 orësh. Në asnjë rrethanë, kohëzgjatja kumulative e punës pa zvogëlim emetimesh, në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore nuk do të tejkalojë 120 orë. Autoriteti kompetent mund të lejojë përjashtime ndaj kufirit të 24 orëve dhe 120 orëve më lart, në rastet kur sipas gjykimit të tyre:

(a) ka një nevojë thelbësore për ruajtjen e furnizimeve me energji, ose

(b) impianti me avari do të zëvendësohej për një periudhë të kufizuar nga një impiant tjetër që do të shkaktonte një rritje të përgjithshme të emetimeve.

2. Autoriteti kompetent mund të lejojë një pezullim, maksimumi për gjashtë muaj nga detyrimi për t'u pajtuar me vlerat kufi të emetimeve të parashikuara në nenin 4 për dyoksidin sulfurik, në lidhje me një impiant që për këtë qëllim, normalisht, përdor karburant me përmbajtje të ulët squfuri që rezulton nga një mungesë serioze. Komisioni do të informohet menjëherë për këto raste.



3. Autoriteti kompetent mund të lejojë përjashtim nga detyrimi për t'iu përmbajtur vlerave kufi të emetimeve të parashikuara në nenin 4, në rastet kur një impiant që normalisht, përdor karburant të gaztë dhe që ndryshe do të kishte nevojë të pajisej me një mjet shërbimi të pastrimit të mbetjeve të gazit, duhet t'i përdorë përjashtimisht, dhe për një periudhë që nuk tejkalon 10 ditë, përveçse kur ka një nevojë thelbësore për të ruajtur furnizimet me energji, për përdorimin e karburanteve të tjera për shkak të një ndërprerjeje të papritur në furnizimin e gazit. Autoriteti kompetent do të informohet menjëherë për çdo rast specifik që mund të ndodhë. Shtetet Anëtare do të informojnë menjëherë Komisionin për rastet e përmendura në këtë paragraf.

## Neni 8

1. Në rastin e impianteve me njësi ndezjeje shumëkomponentëshe që përfshijnë përdorimin e njëkohshëm të dy ose më shumë karburanteve, kur jepet licenca e përmendur në nenet 4 pika (1) ose 4 pika (2), dhe në rast të këtyre impianteve të mbuluara nga nenet 4 pika (3) ose 10, autoriteti kompetent do të caktojë vlerat kufi të emetimeve si më poshtë:

- (a) së pari, duke marrë vlerën kufi të emetimeve që lidhet me secilin karburant individual dhe ndotësin që i korrespondon kapacitetit teknik nominal të impiantit të djegies, të dhënë në Shtojcat III deri në VII,
- (b) së dyti, duke përcaktuar vlerat kufi të emetimeve të ngarkuar me karburante që përftohen duke shumëzuar vlerën kufi të emetimit individual të mësipërm me kapacitetin termik të dhënë nga çdo karburant, produkti i shumëzimit pjesëtohet me shumën e kapaciteteve termike të dhëna nga të gjithë karburantet,
- (c) së treti, duke mbledhur në total vlerat kufi të ngarkuara me karburant.

2. Në njësitë me ndezje shumëpërbërësish që përdorin mbetjet e distilimit dhe shndërrimit nga rafineria e naftës bruto për konsum të vet, vetëm ose me karburante të tjera, do të zbatohen dispozitat për karburantin me vlerën kufi më të lartë të emetimit (karburanti përcaktues), pavarësisht paragrafit 1 më lart, nëse gjatë punës së një impianti të djegies, raporti i kontribuar nga ai karburant në shumën e kapaciteteve termike të dhëna nga të gjithë karburantet është të paktën 50 %.

Kur raporti i karburantit përcaktues është më i ulët se 50 %, vlera kufi e emetimit përcaktohet mbi bazë proporcionale të kapacitetit të nxehtësisë të dhënë nga karburantet individuale në lidhje me shumën e kapaciteteve termike të dhëna nga të gjithë karburantet si më poshtë:

- (a) së pari, duke marrë vlerën kufi të emetimit që ka lidhje me secilin karburant dhe ndotës individual që i korrespondon kapacitetit nominal të nxehtësisë të impiantit djegës, të dhënë në Shtojcën III deri në VII,
- (b) së dyti, duke llogaritur vlerën kufi të emetimit të karburantit përcaktues (karburanti me vlerën më të lartë kufi të emetimit sipas Shtojcave III deri VII dhe në rast të dy karburanteve që kanë të njëjtën vlerë kufi emetimi, karburanti me kapacitet më të lartë termik); kjo vlerë përftohet duke shumëzuar vlerën kufi të emetimit të përcaktuar në Shtojcat III deri VII për atë karburant me një faktor me dy, dhe duke zbritur nga ky produkt vlerën kufi të emetimit të karburantit me vlerën më të ulët kufi të emetimit,
- (c) së treti, duke përcaktuar vlerat kufi të emetimit të ngarkuar me karburant që përftohen duke shumëzuar vlerën kufi të llogaritur të emetimeve të karburanteve me kapacitetin termik të karburantit përcaktues dhe vlera kufi të tjera individuale të emetimeve me kapacitetin termik të dhënë nga secili karburant, prodhimi i shumëzimit pjesëtohet me shumën e kapaciteteve termike të dhëna nga të gjithë karburantet,
- (d) së katërti, duke mbledhur në total vlerat kufi të emetimeve të ngarkuara me karburant.

3. Si alternativë për paragrafin 2, mund të zbatohen vlerat mesatare kufi të mëposhtme të emetimeve për dyoksidin sulfurik (pavarësisht nga kombinimi i përdorur i karburantit):

- (a) për impiantet e përmendura në nenin 4 pikat (1) dhe (3):  $1\ 000\ \text{mg}/\text{Nm}^3$ , të llogaritura mesatarisht për të gjitha këto impiante brenda rafinerisë;
- (b) për impiantet e reja të përmendura në nenin 4 pika (2):  $600\ \text{mg}/\text{Nm}^3$ , të llogaritura mesatarisht për të gjitha këto impiante brenda rafinerisë, me përjashtim të turbinave me gaz.

Autoritetet kompetente do të sigurojnë që zbatimi i kësaj dispozite të mos çojë në rritje të emetimeve nga impiantet ekzistuese.

4. Në rast të impianteve me një njësi ndezjeje shumëkomponentëshe që përfshin përdorimin alternativ të dy ose më shumë karburanteve, kur jepet licenca e përmendur në nenin 4 pikat (1) dhe (2), dhe në rast të këtyre impianteve të mbuluara nga nenet 4 pika (3) ose 10, zbatohen vlerat kufi të emetimeve të përcaktuara në Shtojcat III deri VII, që i korrespondojnë secilit karburant të përdorur.

#### Neni 9

Mbetjet e gazrave nga impiantet e djegies shkarkohen në mënyrë të kontrolluar me anë të një tubi shkarkimi. Licenca e përmendur në nenin 4 dhe licencat për impiantet e djegies të mbuluara nga neni 10, përcaktojnë kushtet e shkarkimit. Autoriteti kompetent do të sigurojë në veçanti që lartësia e tubit të shkarkimit të llogaritet në mënyrë të tillë që të mbrojë shëndetin dhe mjedisin.

#### Neni 10

Kur një impiant i djegies zgjerohet me të paktën 50 MW, vlerat kufi të emetimeve të përcaktuara në pjesën B të Shtojcave III deri VII, do të zbatohen për pjesën e re të impiantit dhe do të fiksohen në lidhje me kapacitetin termik të të gjithë impiantit. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet në rastet e përmendura në nenin 8 pikat (2) dhe (3).

Kur operatori i një impianti të djegies parashikon një ndryshim në nenet 2 pika (10)(b) dhe 12 pika (2) të Direktivës 96/61/KE, do të zbatohen vlerat kufi të emetimeve të përcaktuara në pjesën B të Shtojcave III deri VII në lidhje me dyoksidin sulfurik, oksidet e azotit dhe pluhurin.

#### Neni 11

Në rast të ndërtimit të impianteve djegëse që mund të kenë pasoja të konsiderueshme në mjedis në një Shtet tjetër Anëtar, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të zhvillohet i gjithë informacioni dhe konsultimi i nevojshëm, në përputhje me nenin 7 të Direktivës së Këshillit 85/337/KEE të 27 qershorit 1985 mbi vlerësimin e pasojave të disa projekteve publike dhe private në mjedis<sup>14</sup>.

#### Neni 12

Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar vëzhgimin në përputhje me Shtojcën VIII (A) të emetimeve nga impiantet e djegies të mbuluara nga kjo direktivë dhe të të gjitha vlerave të tjera të kërkuara për zbatimin e kësaj direktive.

Shtetet Anëtare mund të kërkojnë që ky vëzhgim të bëhet me shpenzimet e operatorit.

#### Neni 13

Shtetet Anëtare do të marrin masa të përshtatshme për të siguruar që operatori të informojë autoritetet kompetente brenda afateve kohore të arsyeshme rreth rezultateve të matjeve të vazhdueshme, kontrollit të pajisjeve matëse, masave individuale dhe të gjitha masave të tjera të realizuara, me qëllim vlerësimin e pajtueshmërisë me këtë direktivë.

<sup>14</sup> GZ L 175, 05. 07. 1985, fq. 40, Direktiva e ndryshuar së fundmi nga Direktiva e Këshillit 97/11/KE (GZ L 73, 14. 03. 1997, fq. 5)

## Neni 14

1. Në rast të matjeve të vazhdueshme, vlerat kufi të emetimeve të përcaktuara në pjesën A të Shtojcave III deri VII, do të konsiderohen sikur të jenë të pajtueshme, nëse vlerësimi i rezultateve tregon për orët e punës brenda vitit kalendarik, që:

- (a) asnjë prej vlerave mesatare mujore kalendarike nuk tejkalon vlerat kufi të emetimeve dhe ;
- (b) në rast të:
  - (i) dyoksidit sulfurik dhe pluhurit: 97 % e të gjithë vlerave mesatare 48 orësh nuk tejkalon 110 % të vlerave kufi të emetimeve,
  - (ii) oksidet e azotit: 95 % e të gjithë vlerave mesatare 49 orësh nuk tejkalon 110 % të vlerave kufi të emetimeve.

Periudhat e përmendura në nenin 7 si dhe periudhat e ndezjes dhe mbylljes nuk do të merren në konsideratë.

2. Në rastet kur kërkohen vetëm matje sporadike ose procedura të tjera të përshtatshme për përcaktim, do të merren në konsideratë vlerat kufi të emetimeve të përcaktuara në Shtojcat III deri VII, sikur të kenë qenë të pajtueshme, nëse rezultatet e secilës prej serive të matjeve ose të procedurave të tjera të përkufizuara dhe të përcaktuara sipas rregullave të parashtruara nga autoritetet kompetente, nuk tejkalojnë vlerat kufi të emetimeve.

3. Në rastet e përmendura në nenin 5 pikat (2) dhe (3), normat e çsulfurizimit do të merren në konsideratë sikur të jenë të pajtueshme, nëse vlerësimi i matjeve i kryer sipas Shtojcës VIII, pika A.3, tregon që të gjitha prej vlerave mesatare mujore kalendarike, ose të gjitha prej vlerave mesatare mujore të rrotullimit, arrijnë normat e kërkuara të çsulfurizimit.

Periudhat e përmendura në nenin 7, si dhe periudhat e ndezjes dhe fikjes nuk do të merren në konsideratë.

4. Për impiantet e reja për të cilat jepet licencë sipas nenit 4 pika (2), vlerat kufi të emetimeve do të merren në konsideratë për orët e punës brenda një viti kalendarik, si të pajtueshme nëse:

- (a) asnjë vlerë mesatare ditore e vërtetuar nuk tejkalon shifrat përkatëse të përcaktuara në pjesën B të Shtojcave III deri VII, dhe
- (b) 95 % e të gjitha vlerave mesatare të vërtetuara mbi bazë orësh gjatë vitit, nuk tejkalon 200 % të shifrave përkatëse të përcaktuara në pjesën B të Shtojcave III deri VII.

Vlerat mesatare të vërtetuara përcaktohen si në pikën A.6 të Shtojcës VIII.

Periudhat e përmendura në nenin 7, si dhe periudhat e ndezjes dhe fikjes nuk do të merren në konsideratë.

## Neni 15

1. Jo më vonë se data 31 dhjetor 1990, Shtetet Anëtare do të informojnë Komisionin në lidhje me programet e hartuara në përputhje me nenin 3 pika (1).

Jo më shumë se një vit pas përfundimit të fazave të ndryshme për zvogëlimin e emetimeve nga impiantet ekzistuese, Shtetet Anëtare do t'i paraqesin Komisionit një raport përmbledhës mbi rezultatet e zbatimit të programeve.

Gjithashtu, kërkohet një raport i ndërmjetëm në mes të secilës fazë.

2. Raportet e përmendura në paragrafin 1 do të japin një vështrim të përgjithshëm të:

- (a) të gjitha impianteve djegëse të mbuluara nga kjo direktivë,
- (b) emetimet e dyoksidit sulfurik dhe oksideve të azotit, shprehur në ton për vit dhe si përqendrime të këtyre substancave në mbetjet e gazrave,
- (c) masat tashmë të marra ose të parashikuara me synim zvogëlimin e emetimeve dhe të ndryshimeve në zgjedhjen e karburantit të përdorur,
- (d) ndryshimet në metodën e punës tashmë të bërë ose të parashikuar,
- (e) mbylljet përfundimtare të impianteve djegëse tashmë të realizuara ose të parashikuara, dhe
- (f) nëse është e nevojshme, vlerat kufi të emetimeve të vendosura në programet në lidhje me impiantet ekzistuese.

Gjatë përcaktimit të emetimeve vjetore dhe përqendrimeve të ndotësve në mbetjet e gazrave, Shtetet Anëtare do të marrin në konsideratë nenet 12, 13 dhe 14.

3. Shtetet Anëtare që zbatojnë nenin 5 ose dispozitat e Nota Bene në Shtojcën III ose shënimet fundore në Shtojcën VI.A, do t'i raportojnë çdo vit Komisionit në lidhje me këtë.

#### Neni 16

Shtetet Anëtare do të caktojnë sanksionet e zbatueshme për shkeljet e dispozitave kombëtare të miratuara sipas kësaj direktive. Sanksionet e parashikuara në këtë mënyrë do të jenë efektive, proporcionale dhe parandaluese.

#### Neni 17

1. Direktiva 88/609/KEE do të shfuqizohet me efekt nga 27 nëntori 2002, pa cenuar paragrafin 2 ose detyrimet e Shteteve Anëtare në lidhje me afatet kohore për përafrimin dhe zbatimin e asaj direktive të renditur në Shtojcën IX të saj.

2. Në rast të impianteve të reja të licencuara para datës 27 nëntor 2002, neni 4 pika (1) e kësaj direktive, neni 4 pika (1), neni 5 pika (2), neni 6, neni 15 pika (3), Shtojcat III, VI, VIII dhe pika A.2 e Shtojcës IX të Direktivës 88/609/KEE të ndryshuara nga Direktiva 94/66/KE do të mbeten në fuqi deri në 1 janar 2008, pas së cilës ato do të shfuqizohen.

3. Referencat ndaj Direktivës 88/609/KEE do të interpretohen si referenca ndaj kësaj direktive dhe do të lexohen në përputhje me tabelën e korrelacionit në Shtojcën X të saj.

#### Neni 18

1. Shtetet Anëtare do të sjellin në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për t'u pajtuar me këtë direktivë para datës 27 nëntor 2002. Ata do të informojnë menjëherë Komisionin në lidhje me këtë.

Kur Shtetet Anëtare miratojnë këto dispozita, ata do të përmbajnë një referencë ndaj kësaj direktive ose do të shoqërohen nga kjo referencë në rast të publikimit të tyre zyrtar. Metodatat e bërjes së kësaj reference do të përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

2. Për impiantin ekzistues dhe për impiantin e ri për të cilin jepet licencë sipas nenit 4 pika (1), dispozitat e pikës A.2 të Shtojcës VIII do të zbatohen nga 27 nëntori i vitit 2004.

3. Shtetet Anëtare do t'i komunikojnë Komisionit tekstet e dispozitave të ligjit kombëtar që ata miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo direktivë.

Neni 19

Kjo direktivë do të hyjë në fuqi ditën e publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 20

Kjo direktivë i adresohet Shteteve Anëtare.

**Nënshkruar në Luksemburg, më 23 tetor 2001.**

Për Parlamentin European

Për Këshillin

Presidenti

Presidenti

**N. Fontaine**

**A. Neyts-Uyttebroeck**

SHTOJCA I

Tavanet dhe synimet e zvogëlimit për emetimet e SO<sub>2</sub> nga impiantet ekzistuese<sup>15 16</sup>

	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Shteti Anëtar	Emeti met SO <sub>2</sub> nga impiantet e mëdha të djegies të 1980 kton	Tavani i emetimeve (kton/vit)			% e zvogëlimit mbi emetimet e 1980			% e zvogëlimit mbi emetimet e përshtatura të 1980		
		Faza 1	Faza 2	Faza 3	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Faza 1	Faza 2	Faza 3
		1993	1998	2003	1993	1998	2003	1993	1998	2003
Belgjika	530	318	212	159	-40	-60	-70	-40	-60	-70
Danimarka	323	213	141	106	-34	-56	-67	-40	-60	-70
Gjermania	2225	1335	890	668	-40	-60	-70	-40	-60	-70
Greqia	303	320	320	320	+6	+6	+6	-45	-45	-45
Spanja	2290	2290	1730	1440	0	-24	-37	-21	-40	-50
Franca	1910	1146	764	573	-40	-60	-70	-40	-60	-70
Irlanda	99	124	124	124	+25	+25	+25	-29	-29	-29
Italia	2450	1800	1500	900	-27	-39	-63	-40	-50	-70
Luksemburgu	3	1,8	1,5	1,5	-40	-50	-60	-40	-50	-50
Holanda	299	180	120	90	-40	-60	-70	-40	-60	-70
Portugalia	115	232	270	206	+102	+135	+79	-25	-13	-34
Mbretëria e Bashkuar	3883	3106	2330	1553	-20	-40	-60	-20	-40	-60
Austria	90	54	36	27	-40	-60	-70	-40	-60	-70
Finlanda	171	102	68	51	-40	-60	-70	-40	-60	-70
Suedia	112	67	45	34	-40	-60	-70	-40	-60	-70

<sup>15</sup> Emetimet shtesë mund të lindin nga kapaciteti i autorizuar në ose pas datës 1 korrik 1987.

<sup>16</sup> Emetimet që vijnë nga impiantet e djegies të autorizuar para datës 1 korrik 1987, por që nuk janë ende në punë para asaj date dhe që nuk janë marrë parasysh në vendosjen e taveve të emetimeve të caktuara nga kjo Shtojcë, ose do të pajtohen me kërkesat e vendosura nga kjo direktivë për impiantet e reja, ose do të shpjegohen në emetimet e përgjithshme nga impiantet ekzistuese që nuk duhet të tejkalojnë tavanet e vendosura në këtë Shtojcë.

SHTOJCA II

Tavanet dhe synimet e zvogëlimit të emetimeve të NOx nga impiantet ekzistuese<sup>17 18</sup>

	0	1	2	3	4	5	6
Shteti Anëtar	Emetimet SO <sub>2</sub> nga impiantet e mëdha të djegies të 1980 kton	Tavani i Emetimeve (kton/vit)		% e zvogëlimit mbi emetimet e 1980		% e zvogëlimit mbi emetimet e përshtatura të 1980	
		Faza 1	Faza 2	Faza 1	Faza 2	Faza 1	Faza 2
		1993 <sup>(1)</sup>	1998	1993 <sup>(1)</sup>	1998	1993 <sup>(1)</sup>	1998
Belgjika	110	88	66	-20	-40	-20	-40
Danimarka	124	121	81	-3	-35	-10	-40
Gjermania	870	696	522	-20	-40	-20	-40
Greqia	36	70	70	+94	+94	0	0
Spanja	366	368	277	+1	-24	-20	-40
Franca	400	320	240	-20	-40	-20	-40
Irlanda	28	50	50	+79	+79	0	0
Italia	580	570	428	-2	-26	-20	-40
Luksemburgu	3	2,4	1,8	-20	-40	-20	-40
Holanda	122	98	73	-20	-40	-20	-40
Portugalia	23	59	64	+157	+178	-8	0
Mbretëria e Bashkuar	1016	864	711	-15	-30	-15	-30
Austria	19	15	11	-20	-40	-20	-40
Finlanda	81	65	48	-20	-40	-20	-40
Suedia	31	25	19	-20	-40	-20	-40

(1) Për arsye teknike, Shtetet Anëtare mund të vonojnë deri në dy vjet datën e fazës 1 për zvogëlimin e emetimeve NOx duke njoftuar Komisionin brenda një muaji nga njoftimi i kësaj direktive.

<sup>17</sup> Emetimet shtesë mund të lindin nga kapaciteti i autorizuar në ose pas datës 1 korrik 1987.


<sup>18</sup> Emetimet që vijnë nga impiantet e djegies të autorizuar para datës 1 korrik 1987, por nuk janë ende në punë para asaj date dhe që nuk janë marrë parasysh në vendosjen e taveve të emetimeve të caktuara nga kjo Shtojcë, ose do të pajtohen me kërkesat e vendosura nga kjo direktivë për impiantet e reja, ose do të shpjegohen në emetimet e përgjithshme nga impiantet ekzistuese që nuk duhet të tejkalojnë tavanet e vendosura në këtë Shtojcë.

## SHTOJCA III

### Vlerat kufi të emetimeve për SO<sub>2</sub>

#### Karburant i ngurtë

A. Vlerat kufi të emetimeve SO<sub>2</sub> të shprehura në mg/Nm<sup>3</sup> (O<sub>2</sub> përmbajtja 6 %) që duhet të zbatohet nga impiante të reja dhe ekzistuese, përkatësisht sipas nenit 4 pika (1) dhe 4 pika (3):



NB. Kur vlerat kufi të emetimeve sa më sipër, nuk mund të arrihen për shkak të karakteristikave të karburantit, do të arrihet një normë çsulfurizimi të paktën 60% në rast të impianteve me kapacitet termik nominal prej më pak ose të barabartë me 100 MWth, 75 % për impiantet më të mëdha se 100 MWth dhe më pak se ose të barabarta me 300 MWth dhe 90 % për impiante më të mëdha se 300 MWth. Për impiantet më të mëdha se 500 MWth, do të zbatohet një normë çsulfurizimi prej të paktën 94 % ose të paktën 92 % kur është lidhur një kontratë për përshtatjen e çsulfurizimit të gazeve të furrës ose pajisjet e injektimit të gëlqeres, dhe puna në njësinë e saj ka filluar para datës 1 janar 2001.

B. SO<sub>2</sub> vlerat kufi të emetimeve të shprehura në mg/Nm<sup>3</sup> (O<sub>2</sub> përmbajtja 6 %) që duhet të zbatohet nga impiante të reja sipas nenit 4 pika (2), me përjashtim të turbinave me gaz.

Tipi i karburantit	50 deri 100 MWth	100 deri 300 MWth	> 300 MWth
Biomasa	200	200	200
Rasti i përgjithshëm	850	200 <sup>1</sup>	200

(1) Me përjashtim të rastit të Rajoneve më të Largëta, ku do të zbatohet 850 deri 200 mg/Nm<sup>3</sup> (rënie lineare).

NB. Kur vlerat kufi të emetimeve nuk mund të arrihen për shkak të karakteristikave të karburantit, njësitë do të arrijnë 300 mg/Nm<sup>3</sup> SO<sub>2</sub>, ose do të arrihet një normë çsulfurizimi prej të paktën 92 % në rast të impianteve me kapacitet termik nominal më pak ose të barabartë me 300 MWth, dhe në rast të impianteve me kapacitet termik nominal më të madh se 300 MWth, do të zbatohet një normë çsulfurizimi prej të paktën 95 %, së bashku me vlerën kufi maksimale të emetimeve të lejueshme prej 400 mg/Nm<sup>3</sup>.




## SHTOJCA IV

### Vlerat kufi të emetimeve për SO<sub>2</sub>

#### Karburante të lëngshëm

A. Vlerat kufi të emetimeve SO<sub>2</sub> të shprehura në mg/Nm<sup>3</sup> (O<sub>2</sub> përmbajtja 3 %) duhet të zbatohet nga impiante të reja dhe ekzistuese, sipas nenit 4 pika (1) dhe 4 pika (3), përkatësisht



B. Vlerat kufi të emetimeve SO<sub>2</sub> të shprehura në mg/Nm<sup>3</sup> (O<sub>2</sub> përmbajtja 3 %) duhet të zbatohen nga impiante të reja sipas nenit 4 pika (2), me përjashtim të turbinave me gaz

50 deri 100 MWth	100 deri 300 MWth	> 300 MWth
850	400 deri 200 (rënie lineare) (1)	200

(1) Me përjashtim të rastit të Rajoneve më të Largëta, ku do të zbatohet 850 deri 200 mg/Nm<sup>3</sup> (rënie lineare).

Në rast të dy njësive me kapacitet termik nominal prej 250 MWth në Kretë dhe Rodos që duhet të licencohen para datës 31 dhjetor 2007, do të zbatohet vlera kufi e emetimeve prej 1 700 mg/Nm<sup>3</sup>.

## SHTOJCA V

### Vlerat kufi të emetimeve për SO<sub>2</sub>

#### Karburante të gaztë

A. Vlerat kufi të emetimeve SO<sub>2</sub> të shprehura në mg/Nm<sup>3</sup> (O<sub>2</sub> përmbajtja 3 %) duhet të zbatohen nga impiante të reja dhe ekzistuese sipas nenit 4 pika (1) dhe 4 pika (3), përkatësisht:

Tipi i karburantit	Vlerat kufi (mg/Nm <sup>3</sup> )
Karburante të gaztë në përgjithësi	35
Gaz i lëngëzuar	5
Gazrat kalorifikë të ulët nga gazifikimi i mbetjeve të rafinerisë, gaz furre me koks, gaz furnalthe	800
Gaz nga gazifikimi i qymyrit	(1)

(1) Këshilli do të vendosë vlera kufi të emetimeve të zbatueshme për këtë gaz në një fazë të mëvonshme, në bazë të propozimeve nga Komisioni që duhet të bëhen, duke marrë parasysh përvojën e mëtejshme teknike.

B. Vlerat kufi të emetimeve SO<sub>2</sub> të shprehura në mg/Nm<sup>3</sup> (O<sub>2</sub> përmbajtja 3 %) që duhet të zbatohen nga impiantet e reja sipas nenit 4 pika (2):

Karburante të gaztë në përgjithësi	35
Gaz i lëngëzuar	5
Gazra kalorifikë të ulët nga furra me koks	400
Gazra kalorifikë të ulët nga furnalthe	200

## SHTOJCA VI

### Vlerat kufi të emetimeve për NO<sub>x</sub> (matur si NO<sub>2</sub>)

A. Vlerat kufi të emetimeve NO<sub>x</sub> të shprehura në mg/Nm<sup>3</sup> (O<sub>2</sub> përmbajtja 6 % për karburantet e ngurtë, 3 % për karburantet e lëngshëm dhe karburantet e gaztë) që duhet të zbatohen nga impiantet e reja dhe ekzistuese sipas nenit 4 pika (1) dhe 4 pika (3), përkatësisht:

Tipi i karburantit	Vlerat kufi <sup>(1)</sup> ( mg/Nm <sup>3</sup> )
<b>I ngurtë <sup>(2), (3):</sup></b>	
50 deri 500 MWth	600
>500 MWth:	500
Nga 1 janari 2016	
50 deri 500 MWth:	600
>500 MWth:	200
<b>I lëngshëm:</b>	
50 deri 500 MWth:	450
>500 MWth:	400
<b>I gaztë</b>	
50 deri 500 MWth:	300
>500 MWth:	200

(1) Përveç rastit të Rajoneve më të Largëta ku vlerat e mëposhtme do të zbatohen:

Të ngurta në përgjithësi: 650

Të ngurta me < 10 % vol komp: 1 300

Të lëngshme: 450

Të gazta: 350

(2) Deri në 31 dhjetor 2015, impiantet e kapaciteti termal nominal më i madh se 500 MW, i cili nga viti 2008 e në vazhdim nuk punon më shumë se 2 000 orë në vit (mesatarja e rrotullimit gjatë një periudhe prej pesë vjetësh):

- në rastin e impiantit të licencuar në përputhje me nenin 4 pika (3)(a), do t'i nënshtrohet një vlere kufi për emetimet e oksidit të azotit (matur si NO<sub>2</sub>) të 600 mg/Nm<sup>3</sup>;

- në rastin e impiantit që i nënshtrohet një plani kombëtar sipas nenit 4 pika (6), do të ketë kontributin e tyre ndaj planit kombëtar të vlerësuar mbi bazë të një vlere kufi prej 600 mg/Nm<sup>3</sup>.

Nga 1 janari 2016, ato impiante që nuk punojnë më shumë se 1 500 orë në vit (mesatarja e rrotullimit gjatë një periudhe prej pesë vjetësh) do t'i nënshtrohen një vlere kufi për emetimet e oksidit të azotit

(matur si NO<sub>2</sub>) të 450 mg/Nm<sup>3</sup>.

(3) Deri në 1 janar 2018, në rast të impianteve që në periudhën 12 mujore që përfundon në 1 janar 2001, punonin dhe vazhdojnë të punojnë me karburante të ngurta përmbajtja e avullueshme e të cilave është më pak se 10 %, do të zbatohet 1 200 mg/Nm<sup>3</sup>.

B. Vlerat kufi të emetimeve të NO<sub>x</sub> të shprehura në mg/Nm<sup>3</sup> që duhet të zbatohen nga impiantet e reja sipas nenit 4 pika (2) me përjashtim të turbinave me gaz

Karburante të ngurtë (O<sub>2</sub> përmbajtja 6 %)

Tipi i karburantit	50 deri 100 MWth	100 deri 300 MWth	> 300 MWth
Biomasa	400	300	200
Rasti i përgjithshëm	400	200 (1)	200

(1) Përveç rastit të Rajoneve më të Largëta ku do të zbatohet 300 mg/Nm<sup>3</sup>.

Karburante të lëngshëm (O<sub>2</sub> përmbajtja 3 %)

50 deri 100 MWth	100 deri 300 MWth	> 300 MWth
400	200 <sup>(1)</sup>	200

(1) Përveç rastit të Rajoneve më të Largëta ku do të zbatohet 300 mg/Nm<sup>3</sup>.

Në rastin e dy njësive me kapacitet termik nominal prej 250 MWth në Kretë dhe Rodos, që duhet të liqencohen para datës 31 dhjetor 2007, do të zbatohet vlera kufi e emetimeve prej 400 mg/Nm<sup>3</sup>.

Karburante të gaztë (O<sub>2</sub> përmbajtja 3 %)

	50 deri 300 MWth	> 300 MWth
Gaz natyror ( shënimi 1)	150	100
Gazra të tjera	200	200

Turbinat me gaz

Vlerat kufi të emetimeve NO<sub>x</sub> të shprehura në mg/Nm<sup>3</sup> (O<sub>2</sub> përmbajtja 15 %) që duhet të zbatohen nga një njësi e vetme turbine me gaz sipas nenit 4 pika (2) (vlerat kufi zbatohen vetëm mbi 70 % të ngarkesës):

	> 50 MWth (kapaciteti termik në kushtet ISO)
Gaz Natyror ( Shënimi 1)	50 ( Shënimi 2)
Karburante të lëngshëm ( Shënimi 3)	120
Karburante të gaztë ( të ndryshme nga gazi natyror)	120

Turbinat me gaz për përdorim në raste emergjencash, të cilat punojnë më pak se 500 orë në vit, përjashtohen nga këto vlera kufi. Operatorit të këtyre impianteve i kërkohet t'i paraqesë çdo vit autoritetit kompetent një raport për atë kohë të përdorur.

Shënim 1: Gazi natyror është metani i formuar në mënyrë natyrore me jo më shumë se 20 % (nga volumi) të inerteve dhe përbërësve të tjerë.

Shënim 2: 75 mg/Nm<sup>3</sup> në rastet e mëposhtme ku efektiviteti i turbinës me gaz përcaktohet në kushtet bazë ISO të ngarkesës:

- turbinat me gaz të përdorura në sisteme të kombinuara nxehtësie dhe energjie që kanë një efektivitet të përgjithshëm më të madh se 75 %;

- turbinat me gaz të përdorura në impiantet me cikël të kombinuar që kanë një efektivitet të përgjithshëm vjetor mesatar elektrik më të madh se 55 %;

-turbinat me gaz për shtyrjet mekanike.

Për turbinat me gaz me cikël të vetëm që nuk hyjnë në ndonjë prej kategorive të mësipërme, por që kanë një efektivitet më të madh se 35 % - të përcaktuara në kushtet bazë ISO të ngarkesës- vlera kufi e emetimeve do të jetë 50\* η/35 ku η është efektiviteti i turbinës me gaz i shprehur si përqindje (dhe në kushte bazë ISO të ngarkesës).

Shënim 3: Kjo vlerë kufi emetimesh zbatohet vetëm për turbinat me gaz që nxjerrin dritë dhe distilatet e mesme.

## SHTOJCA VII

### Vlerat kufi të emetimeve për pluhurin

- A. Vlerat kufi të emetimeve të pluhurit, të shprehura në  $\text{mg}/\text{Nm}^3$  ( $\text{O}_2$  përmbajtja 6 % për karburantet e ngurtë, 3 % për karburantet e lëngshëm dhe karburantet e gaztë) që duhet të zbatohen nga impiantet e reja dhe ekzistuese sipas nenit 4 pika (1) dhe 4 pika (3), përkatësisht:

Tipi i karburantit	Kapaciteti termik nominal (MW)	Vlerat kufi të emetimeve ( $\text{mg}/\text{Nm}^3$ )
I ngurtë	$\geq 500$	50 <sup>(2)</sup>
	$< 500$	100
I lëngshëm <sup>(1)</sup>	të gjitha impiantet	50
I gaztë	të gjitha impiantet	5 si rregull 10 për gazin e furnaltës 50 për gazrat e prodhuara nga industria e çelikut që mund të përdoret diku tjetër

(1) Një vlerë kufi prej  $100 \text{ mg}/\text{Nm}^3$  mund të zbatohet për impiantet me kapacitet termik nominal më pak se 500 MWth që djeg karburant të lëngshëm me përmbajtje hiri prej më shumë se 0,06 %.

(2) Një vlerë kufi prej  $100 \text{ mg}/\text{Nm}^3$  mund të zbatohet për impiantet e licencuara sipas nenit 4 pika (3) me kapacitet termik nominal më të madh ose të barabartë me 500 MWth që djeg karburant të ngurtë me përmbajtje nxehtësie më pak se 5 800 kJ/kg (vlerë kalorifike neto), përmbajtje lagështie më të madhe se 45 % nga pesha, një lagështi të kombinuar dhe përmbajtje hiri më të madhe se 60 % nga pesha dhe një përmbajtje oksidi kalciumi më të lartë se 10 %.

- B. Vlerat kufi të emetimit të pluhurave të shprehura në  $\text{mg}/\text{Nm}^3$  që duhet të zbatohen nga impiantet e reja, sipas nenit 4 pika (2) me përjashtim të turbinave me gaz:

Karburante të ngurtë (përmbajtja  $\text{O}_2$  prej 6 %)

50 deri 100 MWth	>100 MWth
50	30

Karburante të lëngshëm (përmbajtja  $\text{O}_2$  prej 3 %)

50 deri 100 MWth	>100 MWth
50	30

Në rast të dy njësive me kapacitet termik nominal prej 250 MWth në Kretë dhe Rodos që duhet të licencohen para datës 31 dhjetor 2007, zbatohet vlera kufi e emetimeve prej  $50 \text{ mg}/\text{Nm}^3$ .

Karburante të gaztë (përmbajtje  $\text{O}_2$  prej 3 %)

Si rregull	5
Për gazin e furnaltës	10
Për gazrat e prodhuar nga industria e çelikut që mund të përdoren diku tjetër	30

## SHTOJCA VIII

### Metodat e matjes së emetimeve

#### A. Procedurat për matjen dhe vlerësimin e emetimeve nga impiantet djegëse.

##### 1. Deri në 27 nëntor 2004

Përqendrimet e SO<sub>2</sub>, pluhuri, NO<sub>x</sub> do të maten në mënyrë të vazhdueshme në rast të impianteve të reja për të cilat kërkohet licenca sipas nenit 4 pika (1) me kapacitet termik nominal prej më shumë se 300 MW. Megjithatë, monitorimi i SO<sub>2</sub> dhe pluhuri mund të kufizohen në matje sporadike ose procedura të tjera të përshtatshme përcaktimi në rastet kur këto matje ose procedura që duhet të verifikohen dhe miratohen nga autoritetet kompetente, mund të përdoren për përfitimin e një përqendrimi.

Në rast të impianteve të reja për të cilat kërkohet licenca sipas nenit 4 pika (1) që nuk mbulohen nga nënparagrafi i parë, autoritetet kompetente mund të kërkojnë matje të vazhdueshme të atyre tre ndotësve që duhet të kryhen kur konsiderohet e nevojshme. Kur nuk kërkohen matje të vazhdueshme, do të përdoren rregullisht matje sporadike ose procedura të përshtatshme përcaktimi të miratuara nga autoritetet kompetente, për të vlerësuar sasinë e substancave të lartpërmendura të pranishme në emetime.

##### 2. Nga 27 nëntori 2002 dhe pa cenuar nenin 18 pika (2)

Autoritetet kompetente do të kërkojnë masa të vazhdueshme të përqendrimeve të SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe pluhurit nga mbetjet e gazrave nga secili impiant i djegies me kapacitet termik nominal prej 100 MW ose më të madh.

Me anë të devijimit nga nënparagrafi i parë, mund të mos kërkohen matje të vazhdueshme në rastet e mëposhtme:

- për impiantet e djegies me jetëgjatësi prej më pak se 10 000 orë pune;

- për SO<sub>2</sub> dhe pluhurin nga boljerat që djegin gaz natyror, ose nga turbinat me gaz që djegin gaz natyror;

- për SO<sub>2</sub> nga turbinat me gaz ose mazut me përmbajtje të njohur squfuri, në rastet kur nuk ka pajisje çsulfurizimi;

- për SO<sub>2</sub> nga mazuti i biomasës nëse operatori mund të provojë se emetimet SO<sub>2</sub> në asnjë rrethanë nuk mund të jenë më të larta sesa vlerat kufi të emetimeve të parashikuara.

Kur nuk kërkohen matje të vazhdueshme, do të kërkohen matje sporadike të paktën çdo gjashtë muaj. Si alternativë, mund të përdoren procedura të përshtatshme përcaktimi që duhet të verifikohen dhe miratohen nga autoritetet kompetente, për të vlerësuar sasinë e ndotësve të lartpërmendur të pranishëm në emetime. Këto procedura do të përdorin standarde CEN sapo ato të bëhen të disponueshme. Nëse standardet CEN nuk janë të disponueshme, do të zbatohen standardet ISO, standardet kombëtare ose ndërkombëtare, të cilat do të garantojnë sigurimin e të dhënave të cilësisë shkencore të barasvlefshme.

##### 3. Në rast të impianteve që duhet të pajtohen me normat e çsulfurizimit të vendosura nga neni 5 pika (2) dhe Shtojca III, do të zbatohen kërkesat në lidhje me matjet e emetimeve SO<sub>2</sub> të vendosura sipas paragrafit 2 të kësaj pike. Për më tepër, përmbajtja e squfurit të karburantit që futet në ambientet e impiantit të djegies, duhet të monitorohet rregullisht.

##### 4. Autoritetet kompetente do të informohen për ndryshimet thelbësore në tipin e karburantit të përdorur ose në mënyrën e punës së impiantit. Ata do të vendosin nëse kërkesat e monitorimit të përcaktuara në paragrafin 2, janë ende të mjaftueshme ose kërkojnë përshtatje.

5. Matjet e vazhdueshme të kryera në pajtim me paragrafin 2 do të përfshijnë procesin, parametrat e punës së procesit përkatës të përmbajtjes së oksigjenit, temperaturës, presionit dhe përmbajtjes së avullimit të ujit. Matja e vazhdueshme e përmbajtjes së avullimit të ujit të gazrave të shfrytëzuara nuk do të jetë e nevojshme, me kusht, që gazi i shfrytëzuar i marrë si kampion të thahet para se të analizohen emetimet.

Matjet përfaqësuese, dmth marrja dhe analiza e kampionëve të ndotësve përkatës dhe parametrave të procesit, si dhe metodat e referencës së matjeve për të kalibruar sistemet e automatizuara të matjeve do të kryhen në përputhje me standardet CEN sapo të bëhen të disponueshme. Nëse standardet CEN nuk janë të disponueshme, do të zbatohen standardet ISO, standardet kombëtare ose ndërkombëtare që do të garantojnë sigurimin e të dhënave të një cilësie shkencore të barasvlefshme.

Sistemet e matjeve të vazhdueshme do t'i nënshtrohen kontrollit me anë të matjeve paralele me metodat e referencës të paktën çdo vit.

6. Vlerat e intervaleve të sigurisë 95 % të një rezultati të vetëm të matur, nuk do të tejkalojnë përqindjet e mëposhtme të vlerave kufi të emetimeve:

Dyoksidi sulfurik      20 %

Oksidet e azotit      20 %

Pluhuri                      30 %

Vlerat e vërtetuara ditore dhe mbi bazë orësh do të përcaktohen nga vlerat e matura mesatare të vlefshme në bazë orësh, pasi të jetë hequr vlera e intervalit të sigurisë të specifikuar më sipër.

Çdo ditë në të cilën më shumë se tre vlera mesatare mbi bazë orësh janë të pavlefshme, për shkak të keqfunksionimit ose ruajtjes së sistemit të vazhdueshëm të matjeve, do të zhvleftësohet. Nëse, më shumë se dhjetë ditë gjatë një viti zhvleftësohen për situata të tilla, autoriteti kompetent do t'i kërkojë operatorit të marrë masa të mjaftueshme për të përmirësuar besueshmërinë e sistemit të vazhdueshëm të monitorimit.

## **B. Përcaktimi i emetimeve totale vjetore të impianteve të djegies**

Deri dhe duke përfshirë vitin 2003, autoritetet kompetente do të përftojnë përcaktimin e emetimeve totale vjetore të SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> nga impiantet e reja të djegies. Kur përdoret monitorimi i vazhdueshëm, operatori i impiantit të djegies do të shtojë veçmas për secilin ndotës, masën e ndotësit të emeluar çdo ditë mbi bazën e normave volumetrike të qarkullimit të mbetjeve të gazrave. Kur monitorimi i vazhdueshëm nuk është në përdorim, llogaritjet e emetimeve totale vjetore do të përcaktohen nga operatori mbi bazën e paragrafit A.1, sipas pëlqimit të autoriteteve kompetente.

Shtetet Anëtare do t'i komunikojnë Komisionit emetimet totale vjetore të SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> të impianteve të reja të djegies, në të njëjtën kohë që kërkohet komunikimi sipas paragrafit C.3 në lidhje me emetimet vjetore totale të impianteve ekzistuese.

Shtetet Anëtare, duke filluar në vitin 2004 dhe për çdo vit pasardhës, do të vendosin një inventar të emetimeve të SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe pluhurit, nga të gjitha impiantet e djegies me kapacitet termik nominal prej 50 MW ose më të madh. Autoriteti kompetent do të përftojë për secilin impiant të drejtuar nën kontrollin e një operatori në një vendndodhje të caktuar, të dhënat e mëposhtme:

- emetime totale vjetore të SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe pluhurit (si grimca totale pezull);

- shuma totale vjetore e kapacitetit të energjisë në lidhje me vlerën kalorifike neto, të ndarë në lidhje me pesë kategori karburantesh: biomasa, karburante të tjerë të ngurtë, karburante të lëngshëm, gaz natyror, gazra të tjerë.

Një përmbledhje e rezultateve të këtij inventari, që tregon emetimet nga rafineritë veçmas, do t'i komunikohet Komisionit çdo tre vjet brenda dymbëdhjetë muajve nga fundi i periudhës tre vjeçare të shqyrtuar. Të dhënat vjetore mbi bazë impianti do t'i vihen në dispozicion Komisionit, sipas kërkesës. Komisioni do të vërë në dispozicion të Shteteve Anëtare një përmbledhje të krahasimit dhe vlerësimit të inventarëve kombëtarë brenda dymbëdhjetë muajve nga marrja e inventarëve kombëtarë.

Duke filluar nga 1 janari 2008, Shtetet Anëtare do t'i raportojnë çdo vit Komisionit, në lidhje me ato impiante ekzistuese të deklaruara për pajtueshmëri sipas nenit 4 pika (4), së bashku me të dhënat e kohës së përdorur dhe të papërdorur të lejuar për jetën e mbetur operacionale të impianteve.

**C. Përcaktimi i emetimeve totale vjetore të impianteve ekzistuese deri në dhe duke përfshirë vitin 2003.**

1. Duke filluar nga viti 1990 dhe për çdo vit në vazhdim, Shtetet Anëtare do të vendosin një inventar të plotë emetimesh për impiantet ekzistuese që mbulojnë SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub>:
  - në bazë impianti për impiantet mbi 300 MWth dhe për rafineritë;
  - mbi bazë të përgjithshme për impiantet e tjera të djegies për të cilat zbatohet kjo direktivë.
2. Metodologjia e përdorur për këta inventarë do të jetë e pajtueshme me atë të përdorur për përcaktimin e emetimeve SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> nga impiantet e djegies në vitin 1980.
3. Rezultatet e këtij inventari do t'i komunikohen Komisionit në një formë të përmbledhur, në mënyrë të përshtatshme brenda nëntë muajsh nga fundi i vitit të shqyrtuar. Metodologjia e përdorur për vendosjen e inventarëve të këtyre emetimeve, dhe informacioni bazë i hollësishëm do t'i vihet në dispozicion Komisionit, me kërkesë të tij.
4. Komisioni do të organizojë një krahasim sistematik të këtyre inventarëve kombëtarë, nëse është e nevojshme, do t'i paraqesë propozime Këshillit që synojnë harmonizimin e metodologjive të inventarit të emetimeve për nevojat e një zbatimi efektiv të kësaj direktive.

**SHTOJCA IX**

**Afatet kohore për përafrimin dhe zbatimin e direktivës së shfuqizuar**

(përmendur në nenin 17 pika (1))

Direktiva	Afatet kohore për përafrim	Afatet kohore për zbatim
88/609/KEE (GZ 336, 7.12.1988, fq. 1)	30 qershor 1990	1 korrik 1990 31 dhjetor 1990 31 dhjetor 1993 31 dhjetor 1998 31 dhjetor 2003
94/66/KE (GZ L 337, 24.12.1994, fq. 83)	24 qershor 1995	



## SHTOJCA X

### Tabela e korelacionit

(përmendur në nenin 17 pika (3))

Kjo direktivë	Direktiva 88/609/KEE
neni 1	neni 1
neni 2	neni 2
neni 3	neni 3
neni 4 pika (1)	neni 4 pika (1)
neni 4 pikat (2), (3) dhe (4)	
neni 4 pika (5)	neni 4 pika (3)
neni 4 pikat (6), (7) dhe (8)	
neni 5	neni 5
	neni 6
neni 6	
neni 7	neni 8
neni 8	neni 9
neni 9	neni 10
neni 10	neni 11
neni 11	neni 12
neni 12	neni 13 pika (1)
neni 13	neni 14
neni 14	neni 15
neni 15 pikat (1), (2) dhe (3)	neni 16 pikat (1), (2) dhe (4)
neni 16	
neni 17	
neni 18 pikat (1), nënparagrafi i parë dhe (3)	neni 17 pikat (1) dhe (2)
neni 18 pikat (1), nënparagrafi i dytë dhe (2) dhe Neni 19	
neni 20	neni 18
Shtojcat I deri VIII	Shtojcat I deri IX
Shtojca IX dhe X	-